

VENDIM
Nr.120, datë 9.10.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “UNION EOLICA ALBANIA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES (PARKU EOLIK KRYEVIDH, KAVAJË), SI BURIM I RINOVUESHËM
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18 dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, neni 8, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 9.10.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Union Eolica Albania” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (parku eolik Kryevidh, Kavajë), si burim i rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “Union Eolica Albania” sh.p.k.

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Union Eolica Albania” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (parku eolik Kryevidh, Kavajë), si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta